



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2020:022673

Datë: 15.02.2021

Numri i dokumentit: 01506687

**P.nr.34/2020**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË**, Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, me sekretaren juridike Behije Karaçica, në çështjen penale ndaj të akuzuarit N. B., për shkak të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së (Kodi nr.06/L-074), ndërsa sipas aktakuzës PP/II.nr.133/20 të dt. 07.02.2020, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar, ku prezent ishin Prokurori i shtetit Nazmi Krasniqi, i akuzuari N.B., si dhe përfaqësuesja e të dëmtuarës K.-A. M., me dt. 21.01.2021, shpallë këtë, ndërsa me dt.15.02.2021 përpilon këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I AKUZUARI: N.B.**, nga i ati A.dhe e ëma Z. e lindjes G., i lindur më datën ..., në fshatin K. - Komuna e Malishevës, ku edhe jeton, e nr.personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, i ati i 4 fëmijëve, i pa shkolluar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Për shkak se nga data e pa vërtetuar e gjerë me datën 22.11.2019, në shtëpinë e tij në fshatin K., Komuna e Malishevës, më qëllim që vetës ti sjell përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me dispozitën e nenit 61 të Ligjit për Energjinë Elektrike të Republikës së Kosovës, nr.05/L-85, ka shfrytëzuar rrymën elektrike në atë mënyrë që gjatë kontrollimit nga ana e zyrtarëve të K.-it, është konstatuar se i pandehurit, jashtë njehsorit elektrik me nr...., ishte kyq në rrjetin elektrik përmes kabllor 4x16mm jashtë matjes së njehsorit, duke anashkaluar kështu regjistrimin e saktë të energjisë së shpenzuar elektrike, me ç'rast ndërmarrjes së dëmtuar K. – Divizioni në Gj. i ka shkaktuar dëm material në shumën e përgjithshme prej 52.64 euro.

- me çka ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së (Kodi nr.06/L-074).

Andaj gjykata konform nenit 4, 7, 17, 38, 39, 40, 43 dhe nenit 69 të KPRK-së (Kodit nr.06/L-074), si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovë të njëjtin:

**E G J Y K O N**

Me Dënimin me Gjobë në lartësi prej **200 € (dyqind)** euro, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në xhirollogarinë e kësaj gjykate në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi i shqiptuar më gjobë do të zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditësh, duke llogaritur çdo 20 euro në një ditë burgu.

E dëmtuara K.- Gj., lidhur me kërkesën pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia paguajnë shumën prej 30.00 euro, si dhe shumën prej 30.00 euro për programin mbi kompensimin e viktimave të krimit, ndërsa shpenzime të procedurës penale nuk ka pasur. Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi do të behet me detyrim.

## **A r s y e t i m**

### 1. Ecuria e procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve.

Prokuroria Themelore në Gjakovë me aktakuzën PP/II.nr.133/20 të dt.07.02.2020, ka akuzuar N.B. nga fshati K. - Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve nga neni 314 parg.6 lidhur me par.1 të KPRK-së duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor si dhe administrimit të gjitha provave, të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 21.01.2021, ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës, prokurori i shtetit Nazmi Krasniqi, i akuzuari N. B., dhe përfaqësuesja e të dëmtuarës K.-A. M., andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

I pandehuri N.B. në shqyrtimin fillestar është deklaruar i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohet, duke shtuar se më vjen keq për rastin i cili ka ndodhur, për të cilin jam penduar, mirëpo nga kushtet e vështira ekonomike, e di që kam bërë gabim, andaj kërkojë nga gjykata të merren parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit, i premtoj gjykatës që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm që mos të kryej kurrfarë vepre penale.

Përfaqësuesja e të dëmtuarës K.- A. M., në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë së të pandehurit, i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe parashtron kërkesë pasurore juridike ndaj të akuzuarit.

Prokurori i shtetit Nazmi Krasniqi, në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë dhe se pranimi i fajësisë mbështetet në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe meqenëse i akuzuari e pranoj fajësinë, me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata t'i ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, dhe i akuzuari të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

### 2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPRK-së. Gjatë pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

### 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akuzuari N. B., me dashje ka kryer veprën penale të vjedhjes së shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së (Kodi nr.06/L-074), në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruara si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

### 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 314 paragrafi 6 të KPRK-së, është parashikuar se “*vjedhja e shërbimeve të gazit, ujit, rrymës ose ngrohjes përfshin, por nuk kufizohet në marrjen, përdorimin, devijimin, nxjerrjen ose përfitimin nga ndonjë shërbim i gazit, ujit, rrymës ose ngrohjes që furnizohet nga ose përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar*”, ndërsa në par.1 është parashikuar se formën themelore të veprës penale vjedhje e shërbimeve e kryen: “*Kushdo që me anë të lajthimit, largimit ose mënyrave tjera siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet*”.

### 5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Duke u bazuar në këto që janë cekur më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin N. B. e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet, ngase në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit formohen të gjitha elementet e veprës penale të vjedhjes së shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së (Kodi nr.06/L-074), për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

### 6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPRK-së (kodi nr.06/L-074), të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, pranimin e fajësisë, pendimin e tij, është i ati i 4 fëmijëve, mbajtës i familjes prej 7 anëtarësh, i gjendjes së dobët ekonomike, asnjëri i punësuar, familjen e mban me punë fizike me punë sezonale në ndërtimtari, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, sjellja e tij korrekte në shqyrtim, kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me gjobë në shumën prej 200 (dyqind) euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, me çka do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 të KPRK-së (Kodi nr.06/L-

074), dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimin mbi udhëzimin në kontestin civil gjykata e mbështeti në nenin 463 par.1 dhe.2 të KPPK-së.

Vendimin mbi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale gjykata e mbështeti në nenin 450 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 parg.3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË**  
**P.nr.34/2020, me dt.21.01.2021.**

**Sekretarja juridike**  
Behije Karaçica

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
Lulzim Paçarizi

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.